



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2026 – Numri: 45

Tiranë – E premte, 27 shkurt 2026

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 124, datë 27.2.2026	Për disa ndryshime në vendimin nr. 4, datë 9.1.2025, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e vlerave për secilin element përbërës të pagës bruto mujore dhe përcaktimin e kriterëve e të procedurave për dhënien e shpërblimeve për punonjësit e Policisë së Shtetit” 3403
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 125, datë 27.2.2026	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 115, datë 5.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, të ndryshuar..... 3407
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 126, datë 27.2.2026	Për disa ndryshime në vendimin nr. 420, datë 26.6.2024, të Këshillit të Ministrave, “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të ushtarakëve aktivë të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar..... 3407
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 127, datë 27.2.2026	Për disa ndryshime në vendimin nr. 425, datë 26.6.2024, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve mësimorë dhe të punonjësve të tjerë jomësimorë në institucionet arsimore dhe në institucionet plotësuese të sistemit arsimor parauniversitar” 3410
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 128, datë 27.2.2026	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 867, datë 10.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për procedurat e bashkëpunimit në institucionet e administratës shtetërore”, të ndryshuar..... 3413
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 129, datë 27.2.2026	Për lirin e drejtorit të përgjithshëm të Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit..... 3414
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 130, datë 27.2.2026	Për emërimin e drejtorit të përgjithshëm të Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit..... 3414

Vendim i Këshillit të Ministrave
nr. 131, datë 27.2.2026

Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 325, datë 31.5.2023, të
Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve
të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit,
funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë
dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike”, të
ndryshuar.....

3414

**VENDIM****Nr. 124, datë 27.2.2026**

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 4, DATË 9.1.2025, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E VLERAVE PËR SECILIN ELEMENT PËRBËRËS TË PAGËS BRUTO MUJORE DHE PËRCAKTIMIN E KRITEREVE E TË PROCEDURAVE PËR DHËNIEN E SHPËRBLIMEVE PËR PUNONJËSIT E POLICISË SË SHTETIT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të shkronjave “a” dhe “b”, të pikës 2, të nenit 8, të ligjit nr. 35/2023, “Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi”, të ndryshuar, dhe të pikave 2, shkronjat “a” e “d”, dhe 4, të nenit 104, të ligjit nr. 82/2024, “Për Policinë e Shtetit”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lidhjet nr. 1, nr. 2 dhe nr. 3, që i bashkëlidhen vendimit nr. 4, datë 9.1.2025, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e vlerave për secilin

element përbërës të pagës bruto mujore dhe përcaktimin e kriterëve e të procedurave për dhënie të shpërblimeve për punonjësit e Policisë së Shtetit”, zëvendësohen me lidhjet me të njëjtët numra dhe tituj, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.

2. Vlerat e elementit “paga për gradë”, në lidhjen nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, janë rezultat i indeksimit në masën 2.5% dhe i politikës së rritjes së pagave për punonjësit me gradën “Inspektor” dhe “Nënkomisar” dhe rezultat i indeksimit në masën 2.5% për gradat e tjera.

3. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi për vitin 2026, përballohen nga buxheti i Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, miratuar në ligjin nr. 87/2025, “Për buxhetin e vitit 2026”.

4. Ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 janar 2026.

KRYEMINISTËR**Edi Rama****Lidhja nr. 1****Paga për gradë për punonjësit e policisë**

Roli i punonjësve sipas gradave	Grada	Paga mujore për gradë
Për punonjësit e rolit madhor	Drejtues Madhor	184,500
	Drejtues i lartë	164,000
Për punonjësit e rolit të mesëm drejtues	Drejtues i parë	138,375
	Drejtues	123,000
Për punonjësit e rolit të parë drejtues	Kryekomisar	107,625
	Komisar	97,375
	Nënkomisar	88,000
Për punonjësit e rolit zbatues	Inspektor	73,500



Grada	Shtesa për natyrë të veçantë pune apo shërbimi për punonjësit e policisë që punojnë në strukturat e luftës kundër krimit të organizuar, krimeve të rënda, antiterrorit dhe në strukturat e policisë shkencore							
	Në funksione të: - Drejtorisë së Forcës së Posaçme Operacionale; - Drejtorisë së Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë; - Njësisë Operacionale për Mbrojtjen e Dëshmitarëve dhe B.D; - Të Sektorit të Forcës së Posaçme të Operacioneve Speciale dhe Kërkimit, në Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë	Në funksione të: - Sektorit të Hetimit nën Mbulim në Drejtorinë e Forcës së Posaçme Operacionale: (Shef Sektori; Ndihmës specialist për përgjimin ambienta e menaxhimit të informatorëve, Seksioni rajonal për menaxhimin e informatorëve)	Në funksione të: Drejtorisë së Forcës së Posaçme Operacionale: - Sektori i hetimit në mbulim (specialist, ndihmës specialist)	Në funksione të: Drejtorisë së Forcës së Posaçme Operacionale: (Shef njësie/ specialist; Përgjegjës grupi; Ndihmës specialist). - Sektori për kërkimin “FAST ALBANIA” (Specialist kërkimi; Ndihmës specialist).	Në funksione të: - Drejtorisë së Antiterrorit; - Për hetimin e krimeve të rënda në strukturat qendrore e vendore të Policisë së Shtetit	Në funksione të: - Sektorit të Zbatimit të Masave Mbrojtëse; - Sektorit të Ndihmës Ligjore dhe Integritetit, në Drejtorinë e Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë	Në funksione të: - Inteligjencës dhe Arkivës Kriminale, në Drejtorinë Vendore të Policisë; Shkencore	Në funksione: - Për Hetimin e Narkotikëve dhe Trafiqeve; - Për Hetimin e Krimit Ekonomik e Financiar; - Për Hetimin e Krimit të Organizuar; - Të Inteligjencës dhe Arkivës Kriminale, në Departamentin e Policisë Kriminale (DPK); - Të Njësisë për mbështetjen Hetimore Ndërkombëtare në DPK; - Të Njësisë për Trajtimin e Informacionit të Klasifikuar në DPK; - Në funksione të Sektorit të Monitorimit Administrativ; - Të Njësisë së Informacionit të Pasagjerit (NIP) në DPK; - Të Policisë Shkencore në strukturat vendore të Policisë së Shtetit; - Për Hetimin e Krimeve Kibernetike në strukturat qendrore e vendore të Policisë së Shtetit; - Për përgjimet ambientale dhe për mbështetjen operacionale të hetimit në DVP; - Sektorit për Përgjimet e Telekomunikacionit në



								Departamentin e Policisë Kriminale
Inspektor	15,500	25,000	39,000	29,500	11,000	15,000	7,000	9,000
Nënkomisar	15,500	25,000		29,500	11,000	15,000	7,000	9,000
Komisar	15,500	25,000		29,500	11,000	15,000	7,000	9,000
Kryekomisar	15,500	25,000	39,000		11,000	15,000	7,000	9,000
Drejtues	15,500	25,000			11,000	15,000	7,000	9,000
Drejtues i parë	15,500	25,000			11,000	15,000	7,000	9,000

Lidhja nr. 3

Grada	Shtesa për natyrë të veçantë pune apo shërbimi për punonjësit e policisë që punojnë në strukturat e ruajtjes së rendit dhe sigurisë publike						
	Në funksione të:	Në funksionet:	Në funksionet:	Në funksionet:	Në funksione:	Në funksione të:	Në funksione të:
	- Njësive speciale “RENEA” (Shef Njësie, zv./ Shef Njësie); - Në strukturat operacionale të Njësive Speciale “RENEA”; - Njësive speciale të negocimit; - Njësive speciale antieksplziv	- Në strukturat e Njësive Speciale të Mbrojtjes së Veçantë NJSMV (Shef njësie, zv. shef njësie, Seksioni operacional për mbrojtjen e personave me cilësi të veçantë); - E seksionit të patrullës së përgjithshme dhe F.P Shqiponja; - Të Forcës së Posaçme “Shqiponja”/ “Shigjeta”	- Për krimet në volum në strukturat qendrore dhe vendore të Policisë së Shtetit; - Policisë Rrugore në strukturat qendrore e vendore të Policisë së Shtetit; - Drejtorisë së Forcave Kombëtare të Sigurisë; - Zv./drejtor në drejtoritë vendore të policisë; - Shef i Komisarariatit të policisë; - Shef stacioni dhe specialist	- Për Rendin Publik në strukturat qendrore e vendore të Policisë së Shtetit; - Policisë Rrugore në strukturat qendrore e vendore të Policisë së Shtetit; - Menaxhimit dhe drejtimit në strukturat qendrore dhe vendore të Policisë së Shtetit; - Analizës strategjike, planifikimit, monitorimit dhe vlerësimit; - Analizës së riskut, analizës strategjike, planifikimit monitorimit dhe vlerësimit; - Patrullës së përgjithshme dhe sigurisë;	- Të Policimit në komunitet në strukturat qendrore dhe vendore të Policisë së Shtetit (shef sektori e seksioni, specialist i policimit në komunitet, specialist, ndihmës specialist për edukimin në shkolla dhe punën me të rinjtë); - Ndihmës specialist/ SPZ; - Specialist/koordinator për SPZ; - Ndihmës specialist, përgjegjës për dhomat e sigurisë dhe trup shërbimi për ruajtjen e dhomave të sigurisë; - Shef Poste policie; - Shef Stacioni policie	- Seksionit të Trajnimit në njësitë e sigurive publike	- Njësive të Sigurisë Publike: (shef njësie dhe strukturat operacionale). - Struktura Operacionale (Seksioni i Operacioneve, Seksioni Operacional, Seksioni Operacional Alpin, Seksioni Operacional Dragot)



				- Të sigurisë dhe shqëritimit, në strukturat vendore të Policisë së Shtetit; - Të rendit publik, në sallat e komandimit, të drejtimit në sektorin/ seksionin e komandës dhe kontrollit; - Ndihmës specialist informacioni, përgjegjës turni, specialist turni dhe informacioni; - Sigurimit të objekteve në strukturat vendore; - Informacionit, ruajtjes dhe sigurimit të objekteve; - Njësisë së Sigurisë dhe Ceremonialit			
Inspektor	65,000	15,500	9,000	6,000	7,000	11,000	25,000
Nënkomisar	65,000	15,500	9,000	6,000	7,000	11,000	25,000
Komisar	65,000	15,500	9,000	6,000	7,000	11,000	25,000
Kryekomisar	65,000	15,500	9,000	6,000	7,000	11,000	25,000
Drejtues	65,000	15,500	9,000	6,000	7,000	11,000	
Drejtues i parë		15,500	9,000	6,000	7,000	11,000	

**VENDIM****Nr. 125, datë 27.2.2026****PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË VENDIMIN NR. 115, DATË 5.3.2014,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
PËRCAKTIMIN E PROCEDURËS
DISIPLINORE DHE TË RREGULLAVE
PËR KRIJIMIN, PËRBËRJEN E
VENDIMMARRJEN NË KOMISIONIN
DISIPLINOR NË SHËRBIMIN CIVIL”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 10, të nenit 59, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 115, datë 5.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, të ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

a) Në kreun I bëhen këto shtesa:

i. Në fund të shkronjës “d”, të pikës 2, shtohen fjalët “... ose zëvendëssekretarin e Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave, për procedurën disiplinore të nisur, sipas shkronjës “b”, të pikës 6/1, të kreut II, të këtij vendimi.”;

ii. Në fund të shkronjës “d”, të pikës 3, shtohen fjalët “... ose zëvendëssekretarin e Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave, për procedurën disiplinore të nisur, sipas shkronjës “b”, të pikës 6/1, të kreut II, të këtij vendimi.”.

b) Pika 6/1, e kreut II, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“6/1. Përfundimisht, kërkesa/rekomandimi i depozituar në institucion, sipas pikës 3, të këtij kreu, i dërgohet komisionit disiplinor për rastet kur:

a) shkeljet disiplinore të pretenduara janë konstatuar nga Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje;

b) shkeljet disiplinore të pretenduara janë konstatuar gjatë veprimtarisë së grupit akselator nga zëvendëssekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave.”.

2. Ngarkohen institucionet, pjesë e fushës së veprimit të legjislacionit për nëpunësin civil, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR**Edi Rama****VENDIM****Nr. 126, datë 27.2.2026****PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN
NR. 420, DATË 26.6.2024, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR TRAJTIMIN ME
PAGË DHE SHTESA MBI PAGË TË
USHTARAKËVE AKTIVË TË FORCAVE
TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të shkronjave “a” e “b”, të pikës 2, të nenit 8, të ligjit nr. 35/2023, “Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi”, dhe të nenit 20, të ligjit nr. 9210, datë 23.3.2004, “Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lidhjet nr. 1 dhe nr. 2, të vendimit nr. 420, datë 26.6.2024, të Këshillit të Ministrave, “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të ushtarakëve aktivë të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, zëvendësohen me lidhjet me të njëjtët numra dhe tituj, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.

2. Vlerat e elementit “pagë bazë për gradë”, në lidhjen nr. 1, si dhe vlerat e elementit “pagë për titull akademik/gradë shkencore/kualifikim shkencor”, në lidhjen nr. 2, janë rezultat i indeksimit në masën 2.5%.



3. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për paga dhe sigurime shoqërore e shëndetësore, për vitin 2026, përballohen nga buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes, miratuar në ligjin nr. 87/2025, “Për buxhetin e vitit 2026”.

4. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 janar 2026.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Lidhja nr.1

PAGA BAZË SIPAS GRADËS DHE VITEVE TË SHËRBIMIT PËR USHTARAKËT AKTIVË TË FORCAVE TË ARMATOSURA TË Republikës së Shqipërisë

OFICERË	Vitet e shërbimit															
	Paga bazë për gradë	Mbi 1 vit	Mbi 2 vjet	Mbi 3 vjet	Mbi 4 vjet	Mbi 6 vjet	Mbi 8 vjet	Mbi 10 vjet	Mbi 12 vjet	Mbi 14 vjet	Mbi 16 vjet	Mbi 18 vjet	Mbi 20 vjet	Mbi 22 vjet	Mbi 24 vjet	Mbi 26 vjet
Gj.Lejtnant (Admiral)																240,875
Gj.Major (Nënadmiral)																230,113
Gj.Brigade (Kundëradmiral)																194,750
Kolonel (Kapiten i rangut I)														162,463	165,538	167,588
Nënkolonel (Kapiten i rangut II)												134,788	136,838	138,888	140,938	142,988
Major (Kapiten i rangut III)									109,675	110,700	112,238	113,775	115,825	117,875	119,925	121,463
Kapiten (Kapiten lejtant)						105,063	106,088	107,625	108,650	109,675						
Toger (Lejtant)				100,450	101,475	103,013	104,550	106,088	107,625	109,675						
Nëntoger (Nënlejtant)	96,350	97,375	98,400	99,425	100,963	101,988	104,038									
NENOFICERË	Vitet e shërbimit															
	Paga bazë për gradë	Nën 2 vjet	Mbi 2 vjet	Mbi 3 vjet	Mbi 4 vjet	Mbi 6 vjet	Mbi 8 vjet	Mbi 10 vjet	Mbi 12 vjet	Mbi 14 vjet	Mbi 16 vjet	Mbi 18 vjet	Mbi 20 vjet	Mbi 22 vjet	Mbi 24 vjet	Mbi 26 vjet
K/Kapitler												94,300	95,325	96,350	97,375	98,400
Kapitler									88,150	89,175	90,200	91,225	92,250	93,275	94,813	95,838
Rreshflier							82,000	83,025	84,050	85,075	86,100	87,125	88,150			
Tetar							80,463	82,000	83,025	84,563						
Nëntetar					75,850	76,875	78,413	79,438	80,463	82,000						
USHTARË AKTIVË	Vitet e shërbimit															
	Paga bazë për gradë	Mbi 1 vit	Mbi 2 vjet	Mbi 3 vjet	Mbi 4 vjet	Mbi 5 vjet	Mbi 6 vjet	Mbi 8 vjet	Mbi 10 vjet	Mbi 12 vjet	Mbi 14 vjet					
Ushtar IV/ Detar IV			72,775	73,288	74,313	74,825	75,850	77,388	78,925	80,975	82,513					
Ushtar III/ Detar III		70,725	71,750													
Ushtar II/ Detar II	68,880	69,905														
Ushtar I/ Detar I	67,855															



Lidhja Nr. 2

STRUKTURA DHE NIVELI I PAGAVE PËR USHTARAKËT AKTIVË TË PERSONELIT AKADEMIK,
NË AKADEMINË E FORCAVE TË ARMATOSURA

Nr.	Grada ushtarake	Pozicioni	Paga për titull akademik/gradë shkencore/kualifikim shkencor	Masa e shtesës për kushte të veçanta tona e shërbimi
1	Gjeneral Brigade/Major	Rektor me titullin “Profesor”	184,000	10,000
2	Kolonel (kapiten i rangut I)	Zëvendësrektor, me titujt “Profesor”/ “Profesor i Asociuar”	174,100	10,000
3	Kolonel (kapiten i rangut I)	Zëvendësrektor, me gradën shkencore “Doktor(PHD)”	171,720	10,000
4	Kolonel (kapiten i rangut I)	Dekan me titujt “Profesor”/ “Profesor i Asociuar”	174,100	10,000
5	Kolonel (kapiten i rangut I)	Zëvendësdekan me titujt “Profesor”/ “Profesor i Asociuar”	159,300	10,000
6	Kolonel (kapiten i rangut I)	Zëvendësdekan nga kategoria “Lektorë”	140,490	10,000
7	Kolonel (kapiten i rangut I)	Përgjegjës i njësisë bazë me titujt “Profesor”/ “Profesor i Asociuar”	163,000	10,000
8	Kolonel (kapiten i rangut I)	Përgjegjës i njësisë bazë nga kategoria “Lektorë”	140,490	10,000
9	Kolonel (kapiten i rangut I)	Titullar i grupit mësimor - kërkimor nga kategoria “Profesor”/ “Profesor i Asociuar”.	163,000	10,000
10	Nënkolonel (kapiten i rangut II)	Titullar i grupit mësimor - kërkimor nga kategoria “Lektorë”	140,490	10,000
11	Kolonel (kapiten i rangut I)	Profesor	159,300	10,000
12	Nënkolonel (kapiten i rangut II)	Profesor i Asociuar	138,400	10,000
13	Nënkolonel (kapiten i rangut II)	Lektorë	118,940	15,000
14	Major (kapiten i rangut III)	Asistent Lektorë	96,600	15,000
15	Kapiten Lejtnant)	Asistent Lektorë	87,700	15,000

**VENDIM****Nr. 127, datë 27.2.2026**

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 425, DATË 26.6.2024, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE TË PUNONJËSVE MËSIMORË DHE TË PUNONJËSVE TË TJERË JOMËSIMORË NË INSTITUCIONET ARSIMORE DHE NË INSTITUCIONET PLOTËSUESE TË SISTEMIT ARSIMOR PARAUNIVERSITAR”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të shkronjave “a” dhe “b”, të pikës 2, të nenit 8, të ligjit nr. 35/2023, “Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi”, të ndryshuar, dhe të neneve 37, pika 5, e 59, pika 3, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lidhjet nr. 1, nr. 2 e nr. 3, të vendimit nr. 425, datë 26.6.2024, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të

punonjësve mësimorë dhe të punonjësve të tjerë jomësimorë në institucionet arsimore dhe në institucionet plotësuese të sistemit arsimor parauniversitar”, zëvendësohen me lidhjet me të njëjtët numra dhe tituj, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.

2. Vlerat e elementit “paga e pozicionit” për:

a) pozicionet me numra rendorë, nga 7 deri në 11, të lidhjes nr. 1, pozicionet me numra rendorë 1 e 2, të lidhjes nr. 2, dhe pozicionet me numra rendorë, nga 5 deri në 8, të lidhjes nr. 3, janë rezultat i indeksimit në masën 2.5% dhe i politikës së rritjes së pagave;

b) pozicionet e tjera janë rezultat i indeksimit në masën 2.5%.

3. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi për vitin 2026, përballohen nga buxheti i institucioneve përkatëse, të miratuara në ligjin nr. 87/2025, “Për buxhetin e vitit 2026”. Për njësitë e vetëqeverisjes vendore përballohen nga transfertat e miratuar në ligjin nr. 87/2025, “Për buxhetin e vitit 2026”, si dhe nga të ardhurat e veta të njëjësive të vetëqeverisjes vendore.

4. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 janar 2026.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Lidhja nr. 1

Vlerat e elementit “pagë për pozicion” dhe grupi i diplomës, për punonjësit mësimorë në institucionet arsimore të sistemit arsimor parauniversitar, të përcaktuara në shkronjat “b”, “c”, “ç” dhe “d”, të pikës 1, të këtij vendimi

Nr.	Emërtimi i pozicionit të punës	Grupi i diplomës	Paga e pozicionit
1	Drejtor i shkollës së mesme me mbi 700 nxënës; Drejtor në Institutin e Nxënësve që nuk Dëgjojnë/Institutin e Nxënësve që nuk Shikojnë/qendrat burimore; Drejtor në institucionet e arsimit special; Drejtor i shkollës në institucionet e arsimit të orientuar me drejtim artistik dhe sportiv, dhe shkollat me status të veçantë.	1	107,120
2	Drejtor i shkollës së mesme me 301 deri në 700 nxënës;	1	105,070



	Zëvendës drejtor i shkollës së arsimit të mesëm të lartë, me mbi 700 nxënës; Zëvendës drejtor në Institutin e Nxënësve që nuk Dëgjojnë/Institutin e Nxënësve që nuk Shikojnë/qendrat burimore; Zëvendës drejtor në institucionet e arsimit special; Zëvendës drejtor i shkollës, në institucionet e arsimit të orientuar me drejtim artistik dhe sportiv, dhe shkollat me status të veçantë; Përgjegjës i bazës prodhuese.		
3	Drejtor i shkollës së mesme me deri në 300 nxënës; Zëvendës drejtor i shkollës së arsimit të mesëm të lartë me 301 deri në 700 nxënës; Drejtor i shkollës 9-vjeçare me mbi 700 nxënës.	1	102,000
4	Zëvendës drejtor i shkollës së arsimit të mesëm të lartë me deri në 300 nxënës; Drejtor i shkollës 9-vjeçare me 301 deri në 700 nxënës.	1	99,950
5	Drejtor i shkollës 9-vjeçare me deri në 300 nxënës.	1	98,950
6	Drejtor i shkollës fillore klasa I–IV; Përgjegjës (kryemësues) i shkollës me klasë kolektive; Zëvendës drejtor i shkollës 9-vjeçare.	1	96,350
7	Mësues koordinator për sigurimin e cilësisë dhe këshillimin e karrierës në shkollat e arsimit të mesëm të lartë dhe arsimit të mesëm të ulët.	1	77,000
8	Mësues në shkollat e arsimit të mesëm të lartë; Mësues në institucionet e arsimit special; Mësues/specialistë/ekspertë të programeve specifike të veçanta, në Institutin e Nxënësve që nuk Dëgjojnë/Institutin e Nxënësve që nuk Shikojnë/qendrat burimore; Mësues/specialistë/ekspertë të programeve specifike të veçanta në institucionet e arsimit të orientuar me drejtim artistik dhe sportiv dhe shkollat me status të veçantë; Mësues i teorisë dhe/ose praktikës profesionale.	1	76,000
9	Specialistë/ekspertë të programeve specifike të veçanta, në Institutin e Nxënësve që nuk Dëgjojnë/Institutin e Nxënësve që nuk Shikojnë/qendrat burimore; Specialistë/ekspertë të programeve specifike të veçanta në institucionet e arsimit të orientuar me drejtim artistik dhe sportiv dhe shkollat me status të veçantë.	2 ose 3, ose 4	76,000
10	Mësues në arsimin e mesëm të ulët në shkollat 9-vjeçare.	1	74,000
11	Mësues në arsimin fillor në shkollat 9-vjeçare; Instruktor i praktikës profesionale.	1 ose 2, ose 3, ose 4.	73,000

Shënim. Kriteret për miratimin e “Mësues koordinator” për sigurimin e cilësisë dhe zhvillimin e karrierës, dhe numri i tyre për institucionet arsimore përcaktohet me urdhër të ministrit përgjegjës për arsimin.



Lidhja nr. 2

Vlerat e elementit “pagë për pozicion” dhe grupi i diplomës, për punonjësit e shërbimit psiko-social dhe për punonjësit e sigurisë në institucionet arsimore të sistemit arsimor parauniversitar të përcaktuara në pikën 1, të këtij vendimi

Nr.	Emërtimi i pozicionit të punës	Grupi i diplomës	Paga e pozicionit
1	Punonjës psiko-social në institucionet e arsimit parauniversitar	1	73,000
2	Oficer i sigurisë në institucionet e arsimit parauniversitar	1	63,000

Lidhja nr. 3

Vlerat e elementit “pagë për pozicion” dhe grupi i diplomës, për punonjësit mësimorë në institucionet arsimore të sistemit arsimor parauniversitar, të përcaktuara në shkronjat “a”, “dh” dhe “e”, të pikës 1, të këtij vendimi

Nr.	Emërtimi i pozicionit të punës	Grupi i diplomës	Paga e pozicionit
1	Drejtore konvikti	1	104,040
2	Drejtore i Qendrës Kulturore të Fëmijëve	1	102,000
3	Drejtore i kopshtit me ushqim	1	82,000
4	Drejtore i kopshtit pa ushqim	1	77,000
5	Përgjegjës sektori në Qendrën Kulturore të Fëmijëve	1	76,000
6	Instruktor në Qendrën Kulturore të Fëmijëve	1	63,000
7	Edukator konvikti; Kujdestar konvikti.	1 ose 2, ose 3 ose 4	61,000
8	Edukator në kopsht fëmijësh	1 ose 2, ose 3 ose 4	61,000

**VENDIM****Nr. 128, datë 27.2.2026****PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË VENDIMIN NR. 867, DATË 10.12.2014,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
PROCEDURAT E BASHKËPUNIMIT NË
INSTITUCIONET E ADMINISTRATËS
SHTETËRORE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 24, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në kreun III, të vendimit nr. 867, datë 10.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për procedurat e bashkëpunimit në institucionet e administratës shtetërore”, të ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

a) Pas pikës 18 shtohen pikat 18/1 dhe 18/2, me këtë përmbajtje:

“18/1. Nëpunësit dhe ekspertët e jashtëm, të cilët caktohen për të qenë pjesë e grupit të përbashkët, nënshkruajnë deklaratën me shkrim, ku pranojnë detyrat dhe përgjegjësitë e punës në grupin e përbashkët, duke u zotuar të ushtrojnë me përgjegjshmëri dhe integritet funksionet në grupin e përbashkët, duke shërbyer me ndershmëri e profesionalizëm, brenda fushës së tyre të përgjegjësisë dhe ekspertizës.

18/2. Secili anëtar i grupit të përbashkët mban përgjegjësi ligjore individuale për punën dhe veprimtarinë e tij, në kuadër të kryerjes së detyrave që i janë caktuar. Përgjegjësia ligjore është e kufizuar brenda fushës së tij të përgjegjësisë, nivelit të ekspertizës dhe veprimtarisë, detyrës e kontributit të dhënë apo të kërkuar, në kuadër të detyrave/ projektit të grupit të përbashkët.”

b) Shkronjat “d” dhe “dh”, të pikës 19, ndryshohen, si më poshtë vijon:

“d) Përcakton detyrat konkrete për secilin prej anëtarëve të grupit të përbashkët, duke marrë në konsideratë:

i. detyrën e përbashkët/projektin e përcaktuar, sipas pikës 9, të këtij kreu;

ii. fushën e përgjegjësisë që mbulon secili anëtar i grupit të punës;

iii. ekspertizën dhe eksperiencën e secilit anëtar të grupit të punës;

iv. institucionin që përfaqëson anëtari i grupit të punës dhe, në rastin e ekspertëve të jashtëm, profilin dhe kualifikimin, si dhe arsyet e angazhimit të tij, të përcaktuara në urdhrin për ngritjen e grupit të punës.

dh) Kontrollon zbatimin e detyrave për secilin prej anëtarëve të grupit të përbashkët dhe mund të kërkojë zëvendësimin e tyre, në rast se performanca e anëtarit është e ulët dhe/ose përbën pengesë për funksionimin dhe mbarëvajtjen e punës.”

c) Pas shkronjës “dh”, të pikës 19, shtohen shkronjat “e”, “ë”, “f” dhe “g”, me këtë përmbajtje:

“e) Identifikon dhe individualizon kontributin e secilit anëtar të grupit të përbashkët;

ë) Kujdeset për përgatitjen e procesverbalit për secilën mbledhje të grupit të përbashkët dhe evidentimin në të të kontributeve individuale të secilit anëtar të grupit të përbashkët;

f) Në përfundim të veprimtarisë së grupit, përmbledh të gjithë dokumentacionin që dëshmon punën dhe kontributin e secilit anëtar dhe ia bashkëlidh ato procesverbaleve të punës që arkivohen, sipas përcaktimeve të bëra në urdhrin për ngritjen e grupit;

g) Kryen çdo veprim tjetër të nevojshëm për realizimin e qëllimit, objektit dhe detyrave, për të cilat është ngritur grupi i përbashkët.”

ç) Pas pikës 20 shtohet pika 20/1, me këtë përmbajtje:

“20/1. Mbledhjet e grupit evidentohen përmes procesverbalit që përgatitet për çdo mbledhje të grupit të punës. Në procesverbalin për çdo mbledhje shënohen diskutimet, kontributet dhe e gjithë veprimtaria e punës së grupit të përbashkët. Procesverbali miratohet dhe nënshkruhet në mbledhjen e ardhshme të grupit.”

d) Në fund të pikës 21 shtohet fjalia, me këtë përmbajtje:

“Në rast se mungesa e anëtarit është e përsëritur dhe përbën pengesë për punën e grupit të punës, drejtuesi i grupit mund të kërkojë zëvendësimin e tij, pranë titullarit të institucionit që e ka caktuar.”



2. Ngarkohen institucionet e administratës shtetërore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 129, datë 27.2.2026

**PËR LIRIMIN E DREJTORIT TË
PËRGJITHSHËM TË DREJTORISË SË
PËRGJITHSHME TË
ANTI-KORRUPSIONIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të kreut III, të vendimit nr. 436, datë 26.6.2024, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin, organizimin e funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Z. Insidor Rexhepi, drejtor i përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit, lirohet nga kjo detyrë.

2. Ngarkohen ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin dhe Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 130, datë 27.2.2026

**PËR EMËRIMIN E DREJTORIT TË
PËRGJITHSHËM TË DREJTORISË
SË PËRGJITHSHME
TË ANTI-KORRUPSIONIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të kreut III, të vendimit nr. 436, datë 26.6.2024, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin,

organizimin e funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Z. Skerdi Tushi emërohet drejtor i përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit.

2. Ngarkohen ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin dhe Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 131, datë 27.2.2026

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA
NË VENDIMIN NR. 325, DATË 31.5.2023,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
MIRATIMIN E STRUKTURËS SË
PAGAVE, NIVELEVE TË PAGAVE DHE
SHITESAVE TË TJERA MBI PAGË
TË ZËVENDËSMINISTRIT,
FUNKSIONARËVE TË KABINETEVE,
PREFEKTIT, NËNPREFEKTIT,
NËPUNËSVE CIVILË DHE
NËPUNËSVE NË DISA INSTITUCIONE
TË ADMINISTRATËS PUBLIKE”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të shkronjave “a” dhe “b”, të pikës 2, të nenit 8, të ligjit nr. 35/2023, “Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi”, të ndryshuar; të shkronjës “h”, të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, dhe të neneve 7 e 9, të ligjit nr. 9584, datë 17.7.2006, “Për pagat, strukturat dhe shpërblyerjet e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të



Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 325, datë 31.5.2023, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në pikën 1, të kreut I, bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

a) Në shkronjën “b”, emërtimi “Agjencia e Inovacionit dhe Ekselencës” zëvendësohet me “Agjencia “*Innovation4Albania*””.

b) Në shkronjën “ç” bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

i. emërtimi “Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara” shfuqizohet;

ii. pas emërimit “Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit” shtohet “Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara”.

c) Në shkronjën “d” bëhen ndryshimet e mëposhtme:

i. emërtimet “Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara” dhe “Agjencia Shtetërore për Mbështetjen dhe Zhvillimin e *Startup*-eve dhe Lehtësuesve” shfuqizohen;

ii. emërtimi “Arkivi Shtetëror i Sistemit Gjyqësor” zëvendësohet me “Arkivi Qendror Shtetëror i Drejtësisë”;

iii. emërtimi “Instituti i Studimeve të Transportit” zëvendësohet me “Instituti i Transportit”.

2. Në kreun III bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Pika 2 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“2. Presidenti i Republikës, Kryetari i Kuvendit, Kryeministri, zëvendëskryeministri, ministrat apo titullarët e institucioneve në varësi të tyre, me qëllim realizimin me efektivitet dhe eficiencë të misionit dhe objektivave të institucionit që drejtojnë kanë të drejtë që, për të marrë këshillimin e duhur për çështje specifike, të kenë këshilltarë të jashtëm apo ndihmës të jashtëm me shtetësi shqiptare apo të

huaj, sipas përcaktimit në shkronjat “a” deri në “d”. Pagesa e këshilltarëve të jashtëm dhe ndihmësve të jashtëm bëhet nga llogaria ekonomike e përcaktuar sipas udhëzimit të ministrit përgjegjës për financat dhe përcaktohet nga:

a) Presidenti, për këshilltarët e jashtëm, të emëruar prej tij, në masën deri në 133 250 (njëqind e tridhjetë e tre mijë e dyqind e pesëdhjetë) lekë në muaj;

b) Kryeministri, për këshilltarët e jashtëm dhe ndihmësit e jashtëm, të emëruar prej tij, në masën, përkatësisht, deri në 133 250 (njëqind e tridhjetë e tre mijë e dyqind e pesëdhjetë) lekë në muaj për këshilltarët e jashtëm dhe deri në 123 000 (njëqind e njëzet e tre mijë) lekë në muaj për ndihmësit e jashtëm;

c) Kryetari i Kuvendit, për këshilltarët e jashtëm të emëruar prej tij, në masën deri në 133 250 (njëqind e tridhjetë e tre mijë e dyqind e pesëdhjetë) lekë në muaj;

ç) Zëvendëskryeministri dhe ministrat, për këshilltarët e jashtëm, të emëruar prej tyre, në masën deri në 123 000 (njëqind e njëzet e tre mijë) lekë në muaj;

d) Titullarët e institucioneve në varësi të Kryeministrit apo ministrave, për këshilltarët e jashtëm, të emëruar prej tyre, në masën deri në 112 750 (njëqind e dymbëdhjetë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë) lekë në muaj.”

b) Pas pikës 2 shtohet pika 2/1, me këtë përmbajtje:

“2/1. Numri maksimal i këshilltarëve të jashtëm:

a) për ministrat nuk duhet të jetë më i madh se numri maksimal i këshilltarëve të kabineteve të ministrave, i përcaktuar në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave, ku të paktën 2 (dy) prej tyre kryejnë detyra të përcaktuara nga negociatorët e grupit negociator;

b) për titullarët e institucioneve në varësi të Kryeministrit apo ministrave nuk duhet të jetë më i madh se 3 (tre), ku të paktën 1 (një) prej tyre kryen detyra që lidhen me çështjet e integritetit në rastet kur titullari i institucionit është pjesë e grupit negociator.”

c) Pika 7/4 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“7/4. Klasat e pagave dhe shtesat për kushte pune (natyrë të veçantë pune) të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat “ekspert”, “ekspert inovacioni”, “drejtor i drejtorive të përmbajtjes”, “zëvendëstitullar institucioni” dhe



“titullar institucioni” në Agjencinë “Innovation4Albania” janë sipas lidhjes nr. 8/4, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.”.

ç) Pas pikës 9/11 shtohen pikat 9/12 dhe 9/13, me këtë përmbajtje:

“9/12. Nivelet e pagave për punonjësit civilë të personelit akademik në Akademinë e Forcave të Armatosura janë sipas lidhjes nr. 10/12, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Të gjitha përcaktimet e tjera të vendimit nr. 748, datë 11.6.2009, të Këshillit të Ministrave, “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të personelit akademik të institucioneve publike të arsimit të lartë”, të ndryshuar, zbatohen edhe për Akademinë e Forcave të Armatosura.”.

9/13. Klasat e pagave dhe shtesat për kushte pune (natyrë të veçantë pune) për pozicionet e punës së nëpunësve në Agjencinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara janë sipas lidhjes nr. 10/13, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.”.

3. Lidhja nr. 1 zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

4. Pika 21, e lidhjes nr. 3, shfuqizohet.

5. Tabela e dytë, e lidhjes 5, zëvendësohet me tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

6. Në lidhjen nr. 6, rreshti që i përket ministrisë përgjegjëse për financat ndryshohet, si më poshtë vijon:

Ministria përgjegjëse për financat	Koordinator në njësitë përgjegjëse për planifikimin dhe monitorimin e buxhetit qendror dhe vendor të Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit.	1	III-2
	Inspektor në drejtorinë përgjegjëse për inspektimin financiar publik.	1	III-1

7. Në pjesët I, II dhe III, të lidhjes nr. 7/1, fjalët “Ndihmës ligjor në gjykatat e apelit” zëvendësohen me “Ndihmës ligjor në gjykatat e apelit, gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm dhe gjykatat administrative të shkallës së parë.”.

8. Në lidhjen nr. 7/3/b, pas fjalëve “Drejtor drejtorie me funksione të nëpunësit zbatues, sipas legjislacionit të menaxhimit buxhetor e financiar” shtohen “Ndihmës ligjor në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.”.

9. Në lidhjen nr. 8, pas emërtesës “Zëvendëskancelar i Kancelarisë së Urdhrave dhe Medaljeve” shtohet “Drejtor i njësisë përgjegjëse për politikën dhe programet e zhvillimit të administratës publike, në Departamentin e Administratës Publike.”.

10. Në lidhjen nr. 9/2, rreshti, që i përket pozicionit “Specialist në Drejtorinë për Koordinimin Juridik”, ndryshohet, si më poshtë vijon:

Specialist në Drejtorinë për Koordinimin Juridik	IV-1	1 ose 2	60 000
--	------	---------	--------

11. Në lidhjen nr. 9/3, vlerat e kolonës “Paga bazë mujore e pozicionit” për pozicionet e punës të klasifikimit doganor C3 dhe D1 bëhen përkatësisht 57 000 dhe 55 600.

12. Në lidhjen nr. 10, fjalët “Përgjegjës i sektorëve të përmbajtjes në Agjencinë Shtetërore të Prokurimeve të Përqendruara”, “Koordinator në Agjencinë Shtetërore të Prokurimeve të

Përqendruara” dhe “Specialist në njësitë organizative të përmbajtjes në Agjencinë Shtetërore të Prokurimeve të Përqendruara” shfuqizohen.

13. Lidhja nr. 10/1 zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.



14. Lidhja nr. 10/9 zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

15. Në lidhjen nr. 11, fjalët “Administrator në Agjencinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara” dhe “Specialist në njësitë organizative të përmbajtjes në Agjencinë Shtetërore për Mbështetjen dhe Zhvillimin e *Startup*-eve dhe Lehtësuesve” shfuqizohen.

16. Lidhja nr. 11/1 zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

17. Lidhja nr. 11/2 zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

18. Lidhja nr. 11/5 zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

II. Vlerat e elementeve të pagës për:

a) klasat III-1, III-2, III-3, IV-1, IV-2, IV-3 dhe IV-4, të lidhjes nr. 1, pozicionet me numrat rendorë 4 dhe 5, të tabelës së dytë, të lidhjes nr. 5, pozicionet e klasifikimit doganor C3 dhe D1, të lidhjes nr. 9/3, pozicioni me numër rendor 3, të lidhjes nr. 11/1, pozicionet me numrat rendorë 2 dhe 3, të lidhjes nr. 11/2 dhe pozicionet e lidhjes nr. 11/5 janë rezultat i

indeksimit në masën 2.5% dhe i politikës së rritjes së pagave;

b) klasat dhe pozicionet e tjera janë rezultat i indeksimit në masën 2.5%.

III. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi për vitin 2026, përballohen nga buxheti i miratuar për secilin nga institucionet, pjesë e fushës së veprimit të tij, të miratuara në ligjin nr. 87/2025, “Për buxhetin e vitit 2026”, dhe fillojnë:

a) për shfuqizimin e përcaktimeve për Agjencinë e Inovacionit dhe Ekselencës dhe Agjencinë Shtetërore për Mbështetjen dhe Zhvillimin e *Startup*-eve dhe Lehtësuesve, si dhe për përcaktimin e shkronjës “c”, të pikës 2, të ndarjes I, të këtij vendimi, nga data e emërimit në detyrë të nëpunësve në Agjencinë “*Innovation4Albania*”;

b) për të gjitha përcaktimet e tjera nga data 1 janar 2026.

IV. Ngarkohen institucionet, pjesë e fushës së veprimit të këtij vendimi, për zbatimin e tij.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR

Edi Rama

Lidhja nr. 1

Kategoritë e klasat e pozicioneve të punës, si dhe vlerat mujore të shtesave të pozicioneve të nëpunësve civilë dhe nëpunësve të institucioneve të përcaktuara në pikën 1, të kreut I, të këtij vendimi, me përjashtim të punonjësve të përcaktuar në pikën 2, të kreut II

Kategoria		Klasa e pagës (pozicioneve të punës për secilën kategori)	Elementet e pagës bruto mujore, përjashtuar shtesat për kushte pune (natyrë të veçantë pune) dhe për kushte të vështira e të dëmshme për shëndetin, që jepen rast pas rasti sipas përcaktimit në këtë vendim		
			Paga për pozicion (lekë në muaj)	Shtesa e nivelit të kualifikimit	Shtesa për vjetërsi (sipas mënyrës së llogaritjes së përcaktuar në shkronjën “ç”, të pikës 1, të kreut II)
1		2	3	4	5
E lartë drejtuese	I	I-1	240 875	1	
		I-1/1	231 650	1	
		I-2	222 425	1	
		I-3	210 125	1	
		I-4	184 500	1	
		I-5	174 250	1	
	II	II-1	158 875	1	



E mesme drejtuese		II-2	144 525	1	
E ulët drejtuese	III	III-1	119 000	1	
		III-2	109 000	1	
		III-3	102 000	1	
Ekzekutive	IV	IV-1	95 000	1 ose 2	
		IV-2	85 000	1 ose 2, ose 3	
		IV-3	75 000	1 ose 2, ose 3	
		IV-4	65 000	1 ose 2, ose 3	

Nr. Rendor	Pozicioni	Vlera e pagës bazë mujore të pozicionit të punës (lek/muaj)
1	Zëvendësministër.	0.85 e pagës së ministrit
2	Prefekt.	210 125
3	Nënprefekt.	174 250
4	Sekretar i Presidentit. Sekretar i Kryeministrit. Sekretar i Kryetarit të Kuvendit. Sekretar i Kryetarit të Gjykatës së Lartë. Sekretar i Prokurorit të Përgjithshëm. Sekretar i zëvendëskryeministrit. Sekretar i Nënkrëtarit të Kuvendit. Sekretar i Avokatit të Popullit. Këshilltar i Prefektit të qarkut Tiranë.	95 000
5	Sekretar i ministrit. Sekretar në zyrën e Avokatit të Popullit. Sekretar i titullarëve të institucioneve të tjera të pavarura, të përmendura në shkronjën “a”, të pikës 1, të kreut I, të këtij vendimi. Sekretar në Kryeministri. Sekretar në aparatet e ministrive të linjës dhe institucionet e pavarura, të përmendura në shkronjën “a”, të pikës 1, të kreut I, të këtij vendimi. Sekretar i organit kolegjial drejtues. Zëdhënës i Prefektit të qarkut Tiranë.	85 000

Lidhja nr. 8/4

Klasat e pagave dhe shtesat për kushte pune (natyrë të veçantë pune) të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat “ekspert”, “ekspert inovacioni”, “drejtor i drejtorive të përmbajtjes”, “zëvendëstitullar institucioni” dhe “titullar institucioni” në Agjencinë “Innovation4Albania”

Pozicioni	Klasa e pagës	Grupi i diplomës	Shtesa për kushte pune (natyrë të veçantë pune) (lek/muaj)
Titullar i institucionit	I-2	1	70 000
Zëvendëstitullar institucioni.	I-4	1	50 000
Drejtor i drejtorive të përmbajtjes	II-1	1	50 000
Ekspert inovacioni	II-1	1	30 000
Ekspert	II-2	1	30 000
Drejtor i drejtorive mbështetëse	II-2	1	0
Përgjegjës sektori në sektorët mbështetës	III-2	1	0
Specialist në sektorët apo drejtoritë mbështetëse	IV-2	1 ose 2 ose 3	0
	IV-3		0



Lidhja nr. 10/1

Nivelet e pagave për punonjësit kërkimorë e shkencorë në Qendrën e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët

Emërtimi	Paga në lekë
Drejtor drejtorie në drejtoritë e përmbajtjes me titull “Profesorë” apo “Profesor i Asociuar”	163 000
Drejtor drejtorie në drejtoritë e përmbajtjes nga kategoria “Lektorë”	140 490
Specialist në drejtoritë e përmbajtjes me titull “Profesorë”	159 300
Specialist në drejtoritë e përmbajtjes me titull “Profesor i Asociuar”	138 400
Specialist në drejtoritë e përmbajtjes nga kategoria “Lektorë”	118 940

Lidhja nr. 10/9

Nivelet e pagave të punonjësve të trupës artistike në Teatrin Kombëtar dhe në Teatrin Kombëtar të Operës, Baletit dhe Ansamblit Popullor

I. Për Teatrin Kombëtar

Nr.	Pozicioni	Paga bazë mujore e pozicionit të punës (lek)
1	Regjisor; Aktor i parë.	154 775
2	Asistent regjisor; Aktor i dytë.	139 400
3	Skenograf i kategorisë së parë.	118 900
4	Aktor i tretë.	108 650
5	Skenograf i kategorisë së dytë.	103 525

II. Për Drejtorinë e Operës dhe Filarmonisë dhe Drejtorinë e Baletit në Teatrin Kombëtar të Operës, Baletit dhe Ansamblit Popullor

Nr.	Pozicioni	Paga bazë mujore e pozicionit të punës (lek)
1	Drejtor artistik i Operës dhe Filarmonisë. Dirigjent i Operës dhe Filarmonisë. Dirigjent (orkestre). Dirigjent (baleti). Dirigjent kori. Solist i parë (lirik, baleti). Koncertmaestër. Baletmaestër. Regjisor.	199 875
2	Spala sektori (orkestre).	187 575
3	Solist II (lirik, baleti, pianist). Spalë sektori (kori).	180 400
4	Asistent dirigjent. Orkestrant i kategorisë së parë.	168 100
5	Orkestrant i kategorisë së dytë.	161 950
6	Solist i tretë (lirik, baleti).	147 600
7	Korist i kategorisë së parë. Balerin i kategorisë së parë. Pianist korepetitor.	138 375
8	Korist i kategorisë së dytë. Pianist përgatitor. Balerin i kategorisë së dytë.	134 790



III. Për Drejtorinë Artistike të Ansamblit të Këngëve dhe Valleve Popullore në Teatrin Kombëtar të Operës, Baletit dhe Ansamblit Popullor

Nr.	Pozicioni	Paga bazë mujore e pozicionit të punës (lek)
1	Drejtor i Ansamblit të Këngëve dhe Valleve Popullore. Mjeshtër vallesh (korepetitor)	174 250
2	Solist i parë Orkestrant i kategorisë së parë; Korist i kategorisë së parë; Valltar i kategorisë së parë.	138 375
3	Orkestrant i kategorisë së dytë; Valltar i kategorisë së dytë; Korist i kategorisë së dytë.	128 125
4	Solist i dytë; Orkestrant i kategorisë së tretë; Valltar i kategorisë së tretë; Korist i kategorisë së tretë.	110 700

Lidhja nr. 10/12

Nivelet e pagave për punonjësit civilë të personelit akademik në Akademinë e Forcave të Armatosura

Nr. rendor	Pozicioni/kategoria	Paga
	<i>1</i>	<i>2</i>
1	Rektor (Titullar i institucionit) me titullin “Profesor”.	184 000
2	Zëvendësrektor me titujt “Profesor” apo “Profesor i Asociuar”.	174 100
3	Zëvendësrektor me gradën shkencore “Doktor (PHD)”.	171 720
4	Dekan me titujt “Profesor” apo “Profesor i Asociuar”.	174 100
5	Zëvendësdekan me titujt “Profesor” apo “Profesor i Asociuar”.	159 300
6	Zëvendësdekan nga kategoria “Lektorë”.	140 490
7	Përgjegjës i njësisë bazë me titujt “Profesor” apo “Profesor i Asociuar” .	163 000
8	Përgjegjës i njësisë bazë nga kategoria “Lektorë”.	140 490
9	Titullar i grupit mësimor/kërkimor me titujt “Profesor” apo “Profesor i Asociuar”.	163 000
10	Titullar i grupit mësimor/kërkimor nga kategoria “Lektorë”.	140 490
11	Profesor.	159 300
12	Profesor i Asociuar.	138 400
13	Lektorë.	118 940
14	Asistent Lektorë.	96 600



Lidhja nr. 10/13

Klasat e pagave dhe shtesat për kushte pune (natyrë të veçantë pune) për pozicionet e punës së nëpunësve në Agjencinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara

Pozicioni	Klasa e pagës	Grupi i diplomës	Shtesa për kushte pune (natyrë të veçantë pune) (lek/muaj)
Titullar i institucionit	I-4	1	15 000
Drejtor i drejtorive të përmbajtjes/Administrator	II-1	1	15 000
Drejtor i drejtorive mbështetëse	II-2	1	0
Përgjegjës i sektorëve të përmbajtjes/Administrator	III-1	1	15 000
Përgjegjës i sektorëve mbështetës	III-2	1	0
Specialist në drejtoritë dhe sektorët e përmbajtjes	IV-1	1 ose 2	0
Specialist në sektorët dhe drejtoritë mbështetëse	IV-2	1 ose 2 ose 3	0
	IV-3		

Lidhja nr. 11/1

Nivelet e pagave të punonjësve të trupës artistike të Teatrit të Kukullave në Qendrën Kombëtare të Kulturës për Fëmijë, të Teatrit Kombëtar Eksperimental “Kujtim Spahivogli” dhe të Cirkut Kombëtar

Nr.	Pozicioni	Paga bazë mujore e pozicionit të punës (lek/muaj)
1	Dirigjent; Regjisor; Drejtues artistik.	139 400
2	Skenograf i kategorisë së parë; Mjeshtër i studios së cirkut; Mjeshtër profili i numrave të cirkut; Aktor i parë; Akrobat i kategorisë së parë; Orkestrant i kategorisë së parë.	118 900
3	Aktor i dytë; Skenograf i kategorisë së dytë; Akrobat i kategorisë së dytë.	95 000

Lidhja nr. 11/2

Nivelet e pagave të punonjësve të trupës artistike në Qendrën e Kulturës, Medias, Botimeve të Mbrojtjes dhe trupën artistike në Batalionin e Mbështetjes së Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura

Nr.	Pozicioni	Paga bazë mujore e pozicionit të punës (lek)
1	Udhëheqës Artistik; Kompozitor.	111 725
2	Dirigjent; Regjisor.	101 000
3	Instrumentist; Vokalist.	87 500



Lidhja nr. 11/5

Vlera e pagës bazë mujore të pozicionit të punës dhe shtesa për kushte pune (natyrë të veçantë pune) në Sektorin e Helikopterëve të Repartit Special RENE A

Pozicioni	Vlera e pagës (lek/muaj)	Shtesa për kushte pune (natyrë të veçantë pune) (lek/muaj)
Shef i sektorit; Pilot; Teknik fluturues	97 100	40 000

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2026

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 96 lekë

